



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1938/4 prot

Datë 15/08/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 767/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/08/2023 me:

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me Nr. REF-75128-07-13-2023, me objekt: “Materiale mjekimi stomatologjike”, me fond limit të lotit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK  
Adresa: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Km 10, Zona Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër  
Adresa: Rruga “Bujar Bishanaku”, Shkodër.

**Persona të Interesuar:** Operatori ekonomik “Amber Dental” SHPK  
Adresa: Njësia Administrative Nr.7, Rruga “Studenti” Pallati 14/E, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.07.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me Nr. REF-75128-07-13-2023, me objekt: “Materiale mjekimi stomatologjike”, me fond limit të lotit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

II.2. Nw datw 31.07.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurwn e mwsipwrme tw prokurimit.

II.3. Në datën 31.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezulton për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1.	“Amber Dental” SHPK	2.194.000 lekë	kualifikuar
2.	“TRIMED” SHPK	2.400.700,25 lekë	kualifikuar

II.4. Në datë 02.08.2023 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të Fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 08.08.2023 operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik me objekt kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej shoqërisë “Amber Dental” SHPK.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1938/2 prot., datë 09.08.2023, janë publikuar kriteret kualifikuese të cilat operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, në ankesën me nr. 1938 prot., datë 08.08.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Amber Dental” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 994/4., datë 10.08.2023 protokolluar me tonën me nr. 1938/3 prot., datë 14.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 10.08.2023 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

*“[...]... Në lidhje me ankesën tuaj ardhur pranë nesh me datë 08.08.2023 drejtuar Autoritetit Kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër protokolluar me tonën me nr 994 Prot datë 08.08.2023, ku keni paraqitur kundërshtimet në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO për procedurën e prokurimit me objekt: "Materiale Mjekimi Stomatologjike" me REF-75128-07-13-2023 ju informojmë si më poshtë:*

*Me marrjen e ankesës, bazuar në LPP neni 112, pika 21, procedura e prokurimit është pezulluar në mbështetje të vendimit të datës 08.08.2023 , nr 994/1 prot deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPP dhe shqyrtimi i saj i është ngarkuar Komisionit të ngritur nga AK me urdhër të datës 09.08.2023 , nr 994/2 Prot për shqyrtimin e ankesës.*

*Pasi u njoha me relacionin dhe konkluzionet e komisionit të ngritur për shqyrtimin e ankesës ju parashtrojmë sqarimet si më poshtë:*

*Në lidhje me pretendimin tuaj se kualifikimi i ofertës së paraqitur prej Amber Dental shpk është në kundërshtim me ligjin dhe DST pasi : “në preventivin e parashikuar për furnizime të publikuar nga AK ( NJVKSH SHKODËR) për këtë procedurë prokurimi disa nga artikujt të cilët do ti renditim më poshtë janë barna, për rrjedhojë i nënshtrohen Ligjit “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar, ku për rrjedhojë për tregtimin e barnave operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licensë II.7.B.1 – Për Tregtim të Barnave”.*

*Konkretisht nga lista e artikujve të kërkuar nga AK në DST nga verifikimi në Rregjistrin e Barnave të publikuar në [www.akbmp.gov.al](http://www.akbmp.gov.al) FAQJA ZYRTARE E Agjencisë Kombëtare të*

Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, rezultojnë barna artikujt; Anestezi lokale me lidokainë 10%, Anestezi me adrenalinë 4%, Betadinë 10%, Eguenol i pastër, Prednizolon, Ujë fiziologjik, Ujë i oksigjenuar, Vitaminë K (bar spitalor), sqarojmë se:

Mbështetur në ligjin Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar, Kreu V “TREGTIMI ME SHUMICË I BARNAVE” Neni 28 përcakton: “Tregtimi me shumicë i barnave” 1. Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjis;lacionit përkatës për licensimin. 2. Tregtuesi farmaceutik me shumicë mund të tregtojë me shumicë edhe pajisjet mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore.;

Neni 31 Tregtimi me shumicë dhe dokumentacioni shoqërues 1. Tregtimi me shumicë i barnave kryhet në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar. 2. Tregtimi me shumicë i barnave bëhet kundrejt faturës dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, forma dhe elementet e të cilit përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Kundërvajtjet administrative 1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga inspektorët farmaceutikë si më poshtë. dh) Kryerja e veprimtarive pa licencën përkatëse, sipas nenit 28, të këtij ligji, dënohet me sekuestrim të barnave. e) Veprimi i kryer në kundërshtim me parashikimet e nenit 29, të këtij ligji, shitja e barnave me shumicë në mungesë të drejtuesit teknik ose farmacistit, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë; shitja e barnave me shumicë pa faturën shoqëruese dhe dokumentacionin përkatës dënohet me 300 000 (treqind mijë) lekë gjobë.” prandaj të gjithë këto artikuj (Anestezi lokale me lidokainë 10%, Anestezi me adrenalinë 4%, Betadinë 10%, Eguenol i pastër, Prednizolon, Ujë fiziologjik, Ujë i oksigjenuar, Vitaminë K (bar spitalor) nuk mund të tregtohen nga një subjekt i cili nuk është i pajisur nga Ministria e Shëndetësisë me Liçencë për tregtimin me shumicë të barnave konkretisht me Licencë II.7.B.1 - “Për Tregtim të Barnave.”

Në këto kushte ankesa juaj përse i përket këtij pretendimi duhet të pranohet.

2. Në lidhje me pretendimin tuaj se kualifikimi i ofertës së paraqitur prej Amber Dental shpk është në kundërshtim DST pasi nuk ka të përcaktuar në fushën e veprimtarisë: “tregtim me shumicë i barnave” sqarojmë se:

Nga verifikimi në [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) rezulton se Amber Dental shpk, nuk ka të përcaktuar tregtimin me shumicë të barnave, pavarësisht se preventivi i AK i procedurës “Materiale Mjekimi Stomatologjike”përmban barna dhe njëkohësisht OE ka ofertuar për listën e barnave për të cilat nuk i ka në objekt të veprimtarisë së tij.

Në këto kushte ankesa juaj përse i përket këtij pretendimi duhet të pranohet.

Në perfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj, Komisioni për Sqyrtimin e Ankesës vlerëson;

1- Pranimin e plotë të ankesës

2- Skualifikimin e OE Amber Dental për shkak të mospërmbushjes së kriterit ligjorë (mungesë e Licencë II.7.B.1 - “Për Tregtim të Barnave.”) dhe kushteve të përgjithshme për kualifikim sipas DST.

3- Shpalljen fitues te OE Trimed Shpk si oferta e sukseshme e cila plotëson të gjitha kapacitetet juridike, financiare dhe teknike. [...]”.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK mbi kundërshtimin vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së shoqërisë “Ámber Dental” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 994/4., datë 10.08.2023 protokolluar me tonën me nr. 1938/3 prot., datë 14.08.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 10.08.2023 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

*“[...]... Në lidhje me ankesën tuaj ardhur pranë nesh me datë 08.08.2023 drejtuar Autoritetit Kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër protokolluar me tonën me nr 994 Prot datë 08.08.2023, ku keni paraqitur kundërshtimet në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO për procedurën e prokurimit me objekt: "Materiale Mjekimi Stomatologjike" me REF-75128-07-13-2023 ju informojmë si më poshtë:*

*Me marrjen e ankesës, bazuar në LPP neni 112, pika 21, procedura e prokurimit është pezulluar në mbështetje të vendimit të datës 08.08.2023 , nr 994/1 prot deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPP dhe shqyrtimi i saj i është ngarkuar Komisionit të ngritur nga AK me urdhër të datës 09.08.2023 , nr 994/2 Prot për shqyrtimin e ankesës.*

*Pasi u njoha me relacionin dhe konkluzionet e komisionit të ngritur për shqyrtimin e ankesës ju parashatrojmë sqarimet si më poshtë:*

*Në lidhje me pretendimin tuaj se kualifikimi i ofertës së paraqitur prej Amber Dental shpk është në kundërshtim me ligjin dhe DST pasi : “në preventivin e parashikuar për furnizime të publikuar nga AK ( NJVKSH SHKODËR) për këtë procedurë prokurimi disa nga artikujt të cilët do të renditim më poshtë janë barna, për rrjedhojë i nënshtrohen Ligjit “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar, ku për rrjedhojë për tregtimin e barnave operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licensë II.7.B.1 – Për Tregtim të Barnave”.*

*Konkretisht nga lista e artikujve të kërkuar nga AK në DST nga verifikimi në Rregjistrin e Barnave të publikuar në [www.akbmp.gov.al](http://www.akbmp.gov.al) FAQJA ZYRTARE E Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, rezultojnë barna artikujt; Anestezia lokale me lidokainë 10%, Anestezia me adrenalinë 4%, Betadinë 10%, Eguenol i pastër, Prednizolon, Ujë fiziologjik, Ujë i oksigjenuar, Vitaminë K (bar spitalor), sqarojmë se:*

Mbështetur në ligjin Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar, Kreu V “TREGTIMI ME SHUMICË I BARNAVE” Neni 28 përcakton: “Tregtimi me shumicë i barnave” 1. Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjis;lacionit përkatës për licensimin. 2. Tregtuesi farmaceutik me shumicë mund të tregtojë me shumicë edhe pajisjet mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore.;

Neni 31 Tregtimi me shumicë dhe dokumentacioni shoqërues 1. Tregtimi me shumicë i barnave kryhet në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar. 2. Tregtimi me shumicë i barnave bëhet kundrejt faturës dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, forma dhe elementet e të cilit përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Kundërvajtjet administrative 1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga inspektorët farmaceutikë si më poshtë. dh) Kryerja e veprimtarive pa licencën përkatëse, sipas nenit 28, të këtij ligji, dënohet me sekuestrim të barnave. e) Veprimi i kryer në kundërshtim me parashikimet e nenit 29, të këtij ligji, shitja e barnave me shumicë në mungesë të drejtuesit teknik ose farmacistit, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë; shitja e barnave me shumicë pa faturën shoqëruese dhe dokumentacionin përkatës dënohet me 300 000 (treqind mijë) lekë gjobë.” prandaj të gjithë këto artikuj (Anestezi lokale me lidokainë 10%, Anestezi me adrenalinë 4%, Betadinë 10%, Eguenol i pastër, Prednizolon, Ujë fiziologjik, Ujë i oksigjenuar, Vitaminë K (bar spitalor) nuk mund të tregtohen nga një subjekt i cili nuk është i pajisur nga Ministria e Shëndetësisë me Liçencë për tregtimin me shumicë të barnave konkretisht me Licencë II.7.B.1 - “Për Tregtim të Barnave.”

Në këto kushte ankesa juaj përse i përket këtij pretendimi duhet të pranohet.

2. Në lidhje me pretendimin tuaj se kualifikimi i ofertës së paraqitur prej Amber Dental shpk është në kundërshtim DST pasi nuk ka të përcaktuar në fushën e veprimtarisë: “tregtim me shumicë i barnave” sqarojmë se:

Nga verifikimi në [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) rezulton se Amber Dental shpk, nuk ka të përcaktuar tregtimin me shumicë të barnave, pavarësisht se preventivi i AK i procedurës “Materiale Mjekimi Stomatologjike”përmban barna dhe njëkohësisht OE ka ofertuar për listën e barnave për të cilat nuk i ka në objekt të veprimtarisë së tij.

Në këto kushte ankesa juaj përse i përket këtij pretendimi duhet të pranohet.

Në perfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj, Komisioni për Sqyrtimin e Ankesës vlerëson;

1- Pranimin e plotë të ankesës

2- Skualifikimin e OE Amber Dental për shkak të mospërmbushjes së kriterit ligjorë (mungesë e Licencë II.7.B.1 - “Për Tregtim të Barnave.”) dhe kushteve të përgjithshme për kualifikim sipas DST.

3- Shpalljen fitues te OE Trimed Shpk si oferta e sukseshme e cila plotëson të gjitha kapacitetet juridike, financiare dhe teknike. [...]”.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave,

*Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “TRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me Nr. REF-75128-07-13-2023, me objekt: “Materiale mjekimi stomatologjike”, me fond limit të lotit 2.500.000

lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “TRIMED” SHPK.
  4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**